



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec



REPUBLIKA E KOSOVES
REPUBLIKA KOSOVA



KOMUNA E RAHOVECIT - OPŠTINA ORAHOVAC
Drejtoria për Administratë të përgjithshme
Odeljenje za Opštu Upravu

-III- Nr. I prot. 5188 Më 24.01.2023
Br. prot. Dt. 24.01.2023
RAHOVEC - ORAHOVAC

Procesverbal i Dëgjimeve për Buxhetin e vitit 2024 dhe Kornizën Afatmesme Buxhetore (KAB) 2024-2026 në

Shtëpinë e Kulturës, Xërxë

INFORMATË RRETH NJOFTIMEVE

Njoftimi për organizimin e dëgjimeve buxhetore për buxhetin e vitit 2024 dhe KAB-in për vitet 2024-2026, u publikua me datë: 28.07.2023 në ueb faqen e komunës së Rahovecit, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> në harmoni me afatet ligjore që i përcakton Udhëzimi Administrativ, si vijon:

*Në mbështetje të nenit 68, paragrafi 68.1 i Ligjit Nr.03L-40 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008), nenit 17 dhe nenit 18 paragrafi 1, pika 1.7, të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005, të datës: 29.03.2017, nenit 6 pika 1.3, i Udhëzimit Administrativ (MAPL) Nr.06/2018 për Standardet Minimale të Konsultimet Publike në Komuna, Rregullores Komunale për Transparencë me Nr. Prot. 2697, njoftojmë se nga data: **14.08.2023** deri me datë: **18.08.2023** nën organizimin e Drejtorisë për Financa dhe Buxhet dhe anëtarëve të Grupit punues për hartimin e Projekt-Buxhetit të Komunës së Rahovecit, do të organizohen njëmbëdhjetë (11) dëgjime publike buxhetore.*

*Dëgjimi publik me qytetaret e fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq, për planifikimin e buxhetit për vitin **2024** dhe KAB-in për vitet **2024-2026**.*

Me qëllim të rritjes së nivelit të transparencës e llogaridhënies dhe për t'i mbajtur sa më të informuar banorët e komunës së Rahovecit, rreth orarit dhe vendit të mbajtjes së dëgjimeve buxhetore, janë bërë me kohë planifikimet dhe është publikuar me kohë kalendar i dëgjimeve buxhetore për njëmbëdhjetë (11) dëgjimet buxhetore në komunën e Rahovecit në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/07/KALENDARI-I-DEGJIMEVE-BUXHETORE-PUBLIKE-ME-QYTETARE-PER-BUXHETIN-E-VITIT-2024.pdf> më datë: 28.07.2023.

Po ashtu, bazuar në afatet ligjore janë njoftuar OJQ-të, Bizneset dhe Grupet e Interesit, Buxhetimi Gjinnor ku janë janë të informuar edhe gjinia **femërore**, si dhe Bashkësitë Lokale dhe lagjet urbane përfaqësuesit të shkollave dhe rininë, rreth mbajtjes së dëgjimeve me anë të publikimit të secilit njoftim veç e veç, për secilin vendbanim, në ueb faqe të komunës, shtatë ditë para mbajtjes së dëgjimit në atë vendbanim.

Njoftimi për mbajtjen e dëgjimit buxhetor me qytetaret e fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq, u publikua më datë 07.08.2023, në këtë vegëz: <https://kk.rks-gov.net/rahovec/wp-content/uploads/sites/23/2023/08/Njoftim-per-mbajtjen-e-degjimit-publik-per-buxhetin-e-vitit-2024-Xerxe.pdf>

Njoftimet, përveç që janë publikuar në ueb-faqe të komunës, në Platformën për Konsultime Publike, në rrjetin social *Facebook*, u janë dërguar edhe kryetarëve të këshillave të fshatrave dhe lagjeve urbane përmes rrjeteve sociale *Viber dhe WhatsApp*.

DËGJIMI PUBLIK ME qytetarët e fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq

Dëgjimi buxhetor me qytetarët e fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq që veprojnë në komunën e Rahovecit u mbajt më:16.08.2023 në Objektin e Shtëpisë së Kulturës në Xërxë, me fillim në orën **19:00**.

Zyrtarët pjesëmarrës në këtë dëgjim nga Grupi punues dhe zyrtarë komunalë, **ishin 6**

- Femra ishin:1,
- Meshkuj ishin: 5

Qytetarë pjesëmarrës gjithsej të pranishëm ishin: 20

- Femra ishin: 0
- Meshkuj ishin: 20

Dëshmi janë listat nënshkruese të pjesëmarrësve në këtë dëgjim.

Dëgjimin e shpalli të hapur drejtori i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, Afrim Limani.

Afrim Limani: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, të nderuar përfaqësues të fshatrave: Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq, ju të pranishëm. Faleminderit që sot jeni këtu!

Jemi sot këtu n; dëgjimet buxhetore, për të marrë kërkesat tuaja si qytetarë të fshatrave Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq, prioritetet që ju keni dhe më pas t'i harmonizojmë në planifikimin që bëhet për vitin 2024.

Buxheti për vitin 2024 do të jetë: 20,034,785.00 euro, **Paga dhe mëditje** në vlerë prej 10,300,983.00 euro, **Mallra dhe Shërbime** në vlerë prej 2,466,340.00 euro, **Shërbime Komunal** në vlerë prej 370,000.00 Euro, **Subvencione dhe Transfere** në vlerë prej 890,000.00 Euro, si dhe **Investimet Kapitale** kapin vlerën prej 6,007,462.00 Euro.

Ju lus që kërkesat edhe pasi t'i paraqisni këtu, me shkrim dhe të protokolluara t'i sillni dhe në Komunë, që më pas të *cedohen* nëpër drejtoritë përkatëse. Nëse ka dikush nga kolegët e KPF-së, mund të bashkëngjiteni, nëse jo urdhëroni ju përfaqësues të Bizneseve dhe grupet e interesit.

Safet Thaqi, qytetar nga fshati Xërxë: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne.

Kërkesat janë:

- Kanalizimi për 8 shtëpi - lagjja kah Drini,
- Problem me trafon e rrymës, afër 40 familje,
- Ndriçimi publik në një pjesë të fshatit Xërxë.

Mensur Gashi, Sapniq: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rugë me kubëza për 8 familje (kjo rugë është në pronësi private).
- Kanalizimi për dy lagje
- Problem me trafon e rrymës për disa familje,
- Rugë fushore,
- Rreth - rrotullimi tek udhëkryqi Fortesë – Sapniq - Pataqan,
- Rruga që lidh Sapniqin dhe Ratkocin afër 180m, të shtrohet me asfalt.

Ibrahim Kqyeziu, qytetar nga fshati Xërxë: të nderuar, përshëndetje, i nderuar kryesues dhe ju të pranishëm! Faleminderit që sot jeni këtu me ne!

Kërkesat janë:

- Rrethimi i varrezave dhe rregullimi i infrastrukturës përreth varrezave (varrezat në dalje të fshatit për Rugovë),
- Rruga “5 Maji” të kubëzohet,
- Rruga “Mitrush Kurteli”, problem me kanalizim dhe të rregullohet kjo rrugë me kubëza.

Afrim Limani: Faleminderit juve përfaqësues të të fshatrave Xërxë, Fortesë, Pataqan i Poshtëm, Sapniq që jeni prezent dhe keni paraqitur kërkesat tuaja.

Mirë u takofshim!

Dëgjimi publik përfundoi në orën: 19:30

Rahovec, 16.8.2023

Ekrem Bytyçi
Kryesues i Grupit Punues